

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Zgjerohet skandali i izraelitit Ron Yeffet, përgjimi: Shkoni në Vlorë dhe bëni çfarë të doni"
ADRESA	https://lapsi.al/zgjerohet-skandali-i-izraelitit-ron-yeffet-pergjimi-shkoni-ne-vlore-dhe-beni-cfare-te-doni-i1093743
BURIMI	lapsi.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	15 shtator 2026, 09:16:11 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	15 shtator 2026, 09:14:03 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	2cfba129f5ff69d197f6e797f719e16f26c17334d88dd275ec6ae3ad551d48f3
TEKSTI	b3777a2aa8bba622568084e283d11332c669a01aed38e194385f63ab0dc826f6
PAMJA	ea00045c24bf93faeb9c76f7cb13b6052f69642cd64ab0cedefc71d4f9de47d8

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	72d9a874cc60f8ed527020b86cf746c8a133b019c88efece01617e8c3bb2ba86
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	908b1c27d6fb4398f588aae15509a84ac3468307df4d4ded5fae648af40858f1
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

https://scan.stamles.eu/verify/72d9a874cc60f8ed527020b86cf746c8a133b019c88efece01617e8c3bb2ba86

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Zgjerohet skandali i izraelitit Ron Yeffet, përgjimi: Shkoni në Vlorë dhe bëni çfarë të doni"

LAPS1.AL • 15 SEPTEMBER 2026



"Shkoni në Vlorë dhe shikoni, bëni çfarë të doni, më pas do të merrem unë me ta" është fjalia më e fortë e përgjimit të dytë të Ron Yeffet, biznesmenit izraelit që shfaqet në audiot e publikuara nga "Çim Peka LIVE", të siguruar nga ish-zëvendëskryeministri Arben Ahmetaj. Nëse në përgjimet e para Yeffet fliste për tregtinë e armëve dhe shfaqej me akses të pazakontë në sektorin e Mbrojtjes, këtë herë ai shfaqet kompetent për një tjetër pasuri strategjike të Shqipërisë: gazin.

Ukrainasit që bisedojnë me Yeffet kërkojnë informacion për pusët dhe rezervat e gazit dhe përpiqen të kuptojnë se si mund të hyjnë në këtë biznes.

Lexo gjithashtu



8 SHTATOR, 22:25

Kush është izraeliti Ron Yeffet i përgjimit të Ahmetajt/ Profil i një biznesmeni të dyshimtë

Në këtë hartë hyn edhe Delvina Gas Company. Sipas Agjencisë Kombëtare të Burimeve Natyrore, marrëveshja për zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në vendburimin e gazit të Delvinës hyri në fuqi më 24 gusht 2007. Operatori fillestar ishte Stream Oil & Gas, më pas TransAtlantic Petroleum dhe, prej vitit 2016, operator është Delvina Gas Company. Licenca rezulton ende në fazën e zhvillimit dhe prodhimit.

Në gusht 2016, përmes një instrumenti transferimi të firmosur mes Albpetrol, AKBN, TransAtlantic Albania dhe Delvina Gas Company, kësaj të fundit iu transferuan 100% e interesave të marrëveshjes hidrokarbure dhe licencës për kërkimin, zhvillimin dhe prodhimin e hidrokarbureve në Bllokun e Delvinës. Bëhet fjalë për pasuri nëntokësore të shtetit, shfrytëzimi i të cilave zhvillohet përmes licencave dhe marrëveshjeve hidrokarbure të miratuara nga institucionet shtetërore.

Por nga mënyra se si flet Ron Yeffet, ligjet për rregullimin e pasurive nëntokësore të Shqipërisë janë thjesht fasadë. Në realitet, Yeffet del garant për çfarëdo marrëveshje

ide



Ortaku besprerë i Ron Yeffetit
Andi Bushati



Insistimi tek krimi, arësyeja përse kryeministri Rama duhet të dorëhiqet
Blendi Kajsiu

MOTITIRANA

27°C

KËMBIMIEURO

91.80

aktuale

28:58

Dhuna policore/ Protestuesit paralajmërojnë përshkallëzim: Do bllokojmë institucionet



Shtatori ndez protestat/ Qytetarët rikthehen në shesh, 107 ditë mobilizim kundër qeverisë



TIA dhe Vodafone sjellin teknologjinë Airbus në Tiranë

Ndiqe Lapsin edhe në



Me interes nga publiku



që kërkohet.

Kur një nga bashkëbiseduesit. Tatiana, gruaja që shërben si përkthyes në bisedë, propozon procedurën më normale të mundshme: t'i kërkohet informacion zyrtar Ministrisë së Energjisë, miku i Ramës ia rrëzon konceptin e negociatave ligjore me qeverinë.

“Jo, jo, asnjë letër zyrtare. Jo! Shikoni, shikoni, shkoni në Vlorë dhe shikoni, bëni çfarë të doni, më pas do të merrem unë me ta. Nuk do të dërgoni asnjë letër, nuk do të dërgoni asgjë. Informacioni është për ne, jo për ministrinë.” dëgjohet të thotë Yeffet.

Kuptohet se Yeffet kundërshton shprehimisht kontaktet me Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë. Partnerët duhet të shkojnë vetë në terren, të kontrollojnë, të pyesin dhe të mbledhin informacion. Pastaj, për hallkën shtetërore, do të kujdesej ai.

Diskutimi i biznesit për gazin dhe pusët, një sektor ku informacioni teknik, licencat, marrëveshjet hidrokarbure dhe miratimet kalojnë domosdoshmërisht përmes institucioneve shtetërore humbin kuptim. Yeffet shkon edhe më tej dhe flet si një sekser që ka në dorë shtetin.

“Mbështetuni te unë për Ministrinë e Energjisë. Do të shkojmë në Ministrinë e Energjisë, do të flasim me ta për çdo gjë, por mos e përmendni emrin tim në Vlorë.”

Në janar 2026, kur sipas materialit të publikuar u zhvillua kjo bisedë, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë drejtohej nga Belinda Balluku.

Mbetet ende për t'u sqaruar se për cilin aset apo marrëveshje konkrete flasin Yeffet dhe bashkëbiseduesit e tij dhe nëse interesi i tyre lidhej drejtpërdrejt me Delvina Gas Company, me asetet e saj apo me një projekt tjetër hidrokarbur. Përgjimi i dytë e zgjeron ndjeshëm skandalin e Ron Yeffet. Pas armëve dhe Mbrojtjes, biznesmeni izraelit shfaqet tani në një bisedë për gazin dhe energjinë, duke pretenduar përsëri se institucionet shqiptare nuk përbënin ndonjë pengesë serioze për planet e tij.

Pjesë nga përgjimi që zgjat 3 orë:

Tatiana: Do të përgatisim një letër zyrtare për Ministrinë e Energjisë, që të arrijmë informacion për gazin në Vlorë. Një letër zyrtare.

Ron Yeffet: Përse? Jo, jo, asnjë letër zyrtare. Jo! Shikoni, shikoni, shkoni në Vlorë dhe shikoni, bëni çfarë të doni, më pas do të merrem unë me ta. Nuk do të dërgoni asnjë letër, nuk do të dërgoni asgjë. Informacioni është për ne, jo për ministrinë.

Tatiana: Dakord. Çështja është thelbësore, ajo që na tha ajo është thelbësore. Të bazohemi vetëm në një vizitë në vend do të ishte joeficiente, e pamjaftueshme. Një inspektim fizik, kompania nuk do të kuptonte asgjë.

Ron Yeffet: Mbështetuni te unë për Ministrinë e Energjisë. Do të shkojmë në Ministrinë e Energjisë, do të flasim me ta për çdo gjë, por mos e përmendni emrin tim në Vlorë.

Tatiana: Dakord.

Ron Yeffet: Dakord. Ju do të përfaqësoni një kompani amerikane.

Tatiana: Dakord.

Ron Yeffet: Do të kontrolloni, do të pyesni për çdo gjë dhe ata do të bashkëpunojnë. I thashë asaj të vijë të hënën, të qëndrojë këtu. Do të shkoni në ministri një, dy, tre herë.

Tatiana: Mendoj se ajo do të vijë të mërkurën.




Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"



PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane



Vajza e saj 10 muajshe ishte me temperaturë të lartë/ Gazetarja rrëfen eksperiencën e tmerrshme në Pediatri të QSUT-së



Del një tjetër PERGJIM i Ron Yeffet: Ministrinë e Energjetikës ma lini mua

Ron Yeffet: Nëse ajo vjen të hënën dhe qëndron, sepse ajo nuk do të jetë të mërkurën dhe të premten, askush nuk punon këtu. Nuk është efiçiente, të jemi më efiçientë.

Tatiana: Dakord.

Ron Yeffet: Nëse jo të mërkurën, ata vijnë të premten, asgjë nuk ndodh dhe ajo duhet të qëndrojë këtu derisa të përfundojmë. Unë dua ta përfundojmë, ju duhet të kuptoni, kam nevojë të filloj. Ne duhet të mbylлим marrëveshje.

Tatiana: Ai po vjen nga Johannesburg. Të hënën do të jetë këtu, nga e marta në mëngjes.

Ron Yeffet: Por ai nuk largohet deri në fundjavë.

Tatiana: Dakord.

Të kështilluara



Rama lëshon Ballukun/ Top Channel nis sulmin: "Pse SPAK vonon kërkesën për arrestimin"

Pas muajsh heshtjeje dhe mbrojtjeje politike, sinjalet nga mediat pranë qeverisë dhe qëndrimi i ri i Edi Ramës tregojnë se Belinda Balluku mund të jetë lënë tashmë vetëm përballë SPAK -ut, në prag të një kërkesë të dytë për arrestimin e saj.



TV francez "C News": Shqiptarët po i bëjnë gjyqin modelit politik Rama

Televizioni francez me prirje të djathta, pronë e miliarderit Vincent Bolloré i ka kushtuar një reportazh protestave në Shqipëri. «Revolucioni i flamingove rozë» është shndërruar në një mobilizim të qëndrueshëm. Si ka mundur të zgjasë kaq shumë dhe deri ku mund të shkojë më tej? Pyet gazetari Romain Gerand




Nga arrestimi i Agasit të klani Balluku/ Pse Rama ndërroi ministrin e Brendshëm




Armë biologjike, dronë dhe bomba bërthamore/ Skenarët e errët të një IA jashtë kontrollit

Ajo mund të nisë një sulm me armë biologjike ose një luftë globale me dronë. Mund të shpërthejë një bomb...



Dy email-et për vilën/ Porosia e Ballukut para se në letra të shfaqej Igli Tare



Dy email-e të shtatorit 2020 tregojnë se Belinda Balluku merret dhe diskutonte projektin luksoz të vilës në Palasë përpara se në dokumentet e pronës të shfaqej Igli Tare, të cilin SPAK e akuzon se u përdor për të fshehur pronësinë faktike të saj.



Nga Aeroporti i Vlorës te Smart City/ Kurthi ndaj Behgjet Pacollit përmes njerëzve të tij të besuar

Dokumentet e siguruar nga Lapsi.al tregojnë se Valon Luka dhe Fitim Pajaziti, dy nga njerëzit e besuar të Behgjet Pacollit përdorën pozicionin e tyre në Mabetex për të futur kompaninë e tyre SSP në marrëveshje me arabët e Smart City, ndërkohë që kompania thotë se në asnjë rast nuk ka qenë e interesuar për projekte që kanë të bëjnë me kamerat e sigurisë.



Kush është izraeliti Ron Yeffet i përgjimit të Ahmetajt/ Profil i një biznesmeni të dyshimtë



5 Përgjimet e Arben Ahmetajt/ Hebreu që negocion në emër të Ramës, pasuritë e Shqipërisë

Historia e lidhjes së Ramës me biznesmenin kontrovers hebreu që ai e bëri partner të shtetit në pronat e ushtrisë. Tentativat për ti hedhur hi syve ambasadës amerikane dhe shprehja: "qeveria na ka ngarkuar punët e pista"



Nderime shtetërore për Ratko Mladiç në Beograd/ Në ceremoni ministrat, priftërinjtë ortodoksë dhe ushtria


Mijëra njerëz, ministra, drejtues të kishës dhe ambasadorë morën pjesë në funeralin e Ratko Mladiçit në Beograd, ndërsa ushtarë serbë u rreshtuan përgjatë kortezhit, duke shkaktuar reagimin e BE-së se glorifikimi i kriminelëve të dënuar të luftës dhe mohimi i gjenocidit nuk kanë vend në një shtet kandidat për anëtarësim.



Sherri i biznesmenëve për pronën/ Çfarë kërkon të grososë Rama nën ulla të Palasës

Reagimi i Luan Muçës ngre dyshimin se pas përplasjes së armatosur në Palasë nuk qëndron një "sherr banal", siç e quajti Rama, por një konflikt pronësie i prodhuar nga institucionet shtetërore, gjurmët e të cilit kryeministri tenton t'i mbyllë përmes shpronësimit të tokës.

Me sytë katër





29:36

PAMJET/ E shau në shkallët e avionit, Rama kap për qafe të riun dhe i dorëzon policisë italiane

Një denoncim është publikuar së fundmi nga një qytetar shqiptar, i cili ndodhej në



Pamje të rënda/ Avokati amerikan i drejton armën ish-gruas së tij në restorant

11:43



PAMJET/ Shoferi ishte pa ndjenja, polici jashtë detyrës ndalon makinën

11:17



Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.